



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETAR I UJIT  
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES ISHEM – ERZEN

VENDIM

Nr. 29 datë 21.09.2012

“Për

miratimin e lejes 3 mujore për shfrytëzimin e inerteve në shtratin e lumit Erzen, subjektit “LA – OR” sh.p.k., Nënkontraktor me kompaninë “COPRI-AKTOR”, me Kontratë-Marreveshje Nr. 19/3 Rep. dhe Nr. 330/2 Kol. Datë 22.06.2012, Aplikim pranë AUB Ishëm-Erzen Nr. 6 datë 11.07.2012, me kërkesën për tu pajisur me Leje bazuar në studimin përkatës.

Në mbështetje të nenit 8 dhe 20 të Ligjit Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, të Vendimit Nr. 3 datë 19.07.2002 të K.K.U, “Për miratimin e rregullores të funksionimit të K.B.U-së Ishëm-Erzen dhe A.U.B-së Ishëm - Erzen”, të Vendimit Nr.2, datë 07.06.2007, të K.K.U-së “Për miratimin e formularit Tip të Lejes për shfrytëzim material inert nga shtreterit e lumenjve”, të Vendimit Nr.1, datë 07.07.2011, të K.K.U-se “Për menaxhimin e shfrytëzimit të zhavorreve për ndërtimin e rrugëve”, të Vendimit Nr.2 datë 27.7.2012 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.1 datë 7.7.2012 të K.K.U-së, “Për menaxhimin e shfrytëzimit të zhavorreve për ndërtimin e rrugëve”, shkresës së MMPAU Nr.5395/1 datë 2.08.2012 “Dërgohet lista e subjekteve që kanë kontratë me DPRR-në për kryerjen e punimeve publike për ndërtimin e rrugëve”, shkresës së MMPAU Nr. 6115 datë 17.08.2012 “ Risjellje në vëmendje të zbatimit të VKKU-së Nr.1 datë 21.06.2006 “Për reduktimin e shfrytëzimit të zhavorreve dhe rëave në shtretërit e lumenjve dhe VKK-së Nr. 1 datë 07.07.2011 “Për menaxhimin e shfrytëzimit të zhavorreve për ndërtimin e rrugëve” dhe shkresës së MMPAU Nr. 5777/1 datë 6.09.2012 “Kthim Përgjigje”, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Ishëm-Erzen;

V E N D O S I

1. **Miratimin e lejes për shfrytëzim inerte në shtratin e lumit Erzen, subjekti “ LA – OR” sh.p.k., Nënkontraktor me kompaninë COPRI-AKTOR.**

2. Sipërfaqja e zonës të studjuar për shfrytëzim  $S = 0.9 \text{ km}^2$

3. Kordinatat e zonës së studjuar për shfrytëzim

$X_1=44 \ 06 \ 103$      $Y_1=45 \ 70 \ 365$      $X_2=44 \ 06 \ 053$      $Y_2=45 \ 70 \ 290$

$X_{16}=44 \ 10 \ 695$      $Y_{16}=45 \ 68 \ 060$      $X_{17}=44 \ 10 \ 695$      $Y_{17}=45 \ 68 \ 150$

4. Thellesia e shfrytëzimit  $h = 1 - 1.5 \text{ m}$

5. Ngarkohet AUB Ishëm-Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

PERGJEGJESI A.U.B  
ISHEM – ERZEN

Bashkim KUKA

KRYETARI I K.B.U  
ISHEM - ERZEN

Keltis KRUIJA